



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



14-111/01-0177099/17-
Dt.21.07.2017

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN VENDEVE TË PUNËS

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.rendor	Niveli	Pozita	Pensionim/Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për gjuhë angleze	Zëvendësim	4
2	ShML	Mësimdhënës/e për gjuhë angleze	Zëvendësim	2
3	ShFMU	Mësimdhënës/e për gjuhë angleze	Vend i lirë	14
4	ShML	Mësimdhënës/e për gjuhë angleze/paralelja në gjuhën boshnjake	Vend i lirë	1
5	ShML	Mësimdhënës/e për gjuhë gjermane	Vend i lirë	7

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë ose në <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Arsimit/Formularet-per-aplikim.aspx>);
- Rezymeja personale (CV).;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).



II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimorë

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 06/2015) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjuhë angleze në shkollë të mesme të ulët:

Fakulteti i Edukimit – programi i gjuhës dhe letërsisë angleze;
Fakulteti i Filologjisë – dega e gjuhës dhe letërsisë angleze.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjuhë angleze në shkollë të mesme të lartë:

Fakulteti i Filologjisë – dega e gjuhës dhe letërsisë angleze;

- Niveli Master;
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar);

Fakulteti Filozofik – dega gjuhë dhe letërsi angleze;

- Niveli Master;
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar);

Ndërsa sa i përket pozitës për mësimdhënës/e për gjuhë angleze/paralelja në gjuhën boshnjake është e domosdoshme njohja e gjuhës boshnjake.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për gjuhë gjermane në shkollë të mesme të lartë:

Fakulteti i Filologjisë – dega e gjuhës dhe letërsisë gjermane;

- Niveli Master;
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar);

Fakulteti Filozofik – dega gjuhë dhe letërsi gjermane;

- Niveli Master;
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar);

SQARIM: Në institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), kandidatët duhet të kenë së paku 300 ETCS, përkatësisht 5 vite studime.

Në intervistë ftohen kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara me Ligj dhe UA (drejtimi adekuat dhe kreditë e mjaftueshme).



Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur për institucionet e arsimit të mesëm të ultë (6-9) dhe arsimit të mesëm të lartë (10-12), do të shqyrtohen dhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim të studimeve 4 vjeçar.

Në intervistë, kandidatët do të vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtëm:

- Njohuri të përgjithshme – 25%;
- Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit – 35%;
- Njohuritë profesionale – 40%, prej të cilave:
 - Nota mesatare – 10%;
 - Përvoja – 10%;
 - Njohuritë mbi vendin e punës – 20%.

III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e Komunës së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit)

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2017, por në varësi të liritimit real i vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me: **21.07.2017 deri më datën 04.08.2017.**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Nëse aplikohet për dy pozita (vend i lirë dhe zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta.

